

EFEKTET NDËRBREZNORE TË PËRVOJËS SË TRAUMËS NË SHQIPËRINË KOMUNISTE

MSc. Lindita Komani
Kryetare Bordi, Instituti Konservator Shqiptar
lindita.komani@gmail.com

Abstrakt

Shqipëria përjetoi disa dekada komunizmi të rëndë, nga viti 1944, deri më 1990, kohë në të cilën trauma e shkaktuar nga regjimi komunist ishte shumë e zakonshme. Ky studim hulumton efektet e traumës ndërbreznore tek viktimat shqiptare të komunizmit. Fëmijë në moshë madhore të viktimave (N=233) raportuan për ankthin, lidhjen e ankthshme dhe shmangëse, nivelin e shpresës, fenë dhe llojin e traumës tek prindërit (humbje e jetës, lirisë ose mundësive) dhe vendndodhjen e tyre aktuale (N=148 në Shqipëri dhe N=84 në SHBA). Gjetjet paraqesin evidencë të efekteve ndërbreznore të traumës, duke treguar prani më të lartë në mënyrë domethënëse të ankthit të rëndë në fëmijët e viktimave të komunizmit sesa në popullsinë e përgjithshme (21,62% në kampionin në Shqipëri dhe 39,28% në kampionin në SHBA). Duke eksploruar rrugët e transmetimit, gjetjet tregojnë që lidhja më e lartë e ankthshme me secilin prind ishte e shoqëruar me nivele më të larta ankthi. Pjesëmarrësit shprehën lidhje më të ulët shmangëse me babanë në rastet kur nëna kishte pësuar traumë, duke shfaqur një proces kompensimi. Për më tej, nivelet më të larta të shpresës ishin të asociuara me ankth më të ulët në kampionin në SHBA, por jo në Shqipëri.

Fjalë Kyçe: *Trauma ndërbreznore, ankthi, lidhja, shpresa, viktimat e komunizmit, Shqipëri dhe SHBA*

Hyrje

Trauma ndërbreznore u shfaq në literaturën psikiatrike në vitet shtatëdhjetë, me publikimin e studimeve mbi të mbijetuarit e Holokaustit. Dukuri të ngjashme u trajtuan më vonë në studimet që përfshinin fëmijët e veteranëve të Luftës së Vietnamit¹. Literatura më e fundit mbi traumën ndërbreznore ka trajtuar tema të tilla si kolonizimi, skllavëria, trauma e zhvendosjes, spastrimi

¹ Rachel Dekel and Hadass Goldblatt, "Is there intergenerational transmission of trauma? The case of combat veterans' children," *American Journal of Orthopsychiatry* 78, no. 3 (2008): 281–89, <https://doi.org/10.1037/a0013955>.

Robert Rosenheck and Alan Fontana, "Transgenerational effects of abusive violence on the children of Vietnam combat veterans," *Journal of Traumatic Stress* 11, no. 4 (1998): 731–42, <https://doi.org/10.1023/A:1024445416821>.

etnik dhe lufta, gjenocidi, persekutimi fetar, diktaturat dhe komunizmi.² Përmes “Ligjit të Miqësisë” (“Friendship Act” - U.S. Congress, 1993),³ Kongresi Amerikan njohu përmasat e krimeve të komunizmit, duke dënuar vrasjet e mbi 100 milionë viktimave që prej vitit 1917. Ligji njohu gjithashtu robërimin e 40 kombeve, ku u vendosën regjime që shtypën popullsinë dhe shkelën në mënyrë drastike të drejtat e njeriut. Një nga këto kombe të robëruara ishte edhe Shqipëria komuniste, midis viteve 1944 dhe 1990, e cila nën regjimin e Enver Hoxhës vrau mijëra shqiptarë dhe ndryshoi përgjithmonë jetën e familjeve të tyre. Viktimat e represionit komunist u vranë, u burgosën, u internuan dhe/ose humbën shumë mundësi në jetë. Ndërkohë që ekzistojnë qindra studime mbi ndikimin e Holokaustit tek të mbijetuarit dhe pasardhësit e tyre,⁴ ndikimi dhe pasojat psikologjike të persekutimit komunist mbeten të pastudiara mjaftueshëm. Deri më sot, vetëm disa studime kanë trajtuar efektet e tij ndërbreznore.⁵ Duke marrë parasysh këtë zbrazëti, ky punim fokusohet në efektet ndërbreznore të traumës së përjetuar në Shqipërinë komuniste. Ky punim paraqet në mënyrë të përmbledhur sfondin kërkimor, metodat, gjetjet kryesore, diskutimin dhe përfundime të një teze master, realizuar në Universitetin “Divine Mercy” në Virginia, SHBA. Literatura mbi efektet ndërbreznore të Holokaustit merret si pikë reference në këtë studim. Kjo literaturë ka kontribuar në teoritë dhe metodat e përdorura në studimet e lidhura drejtpërdrejt me komunizmin dhe më konkretisht me Shqipërinë komuniste. Me interes të veçantë janë marrëdhëniet statistikore midis traumës, ankthit, lidhjes emocionale (attachment)⁶, përkushtimit ndaj fesë dhe shpresës. Teoria e lidhjes emocionale shërben si kornizë shpjeguese për transmetimin e traumës tek brezi pasardhës. Gjithashtu, bëhet një krahasim midis pasardhësve të viktimave të komunizmit, që vazhdojnë të jetojnë në Shqipëri dhe atyre që kanë nisur një jetë të re, duke emigruar në Shtetet e Bashkuara pas rënies së komunizmit. Rezultatet e studimit mund të kontribuojnë në mbështetjen e përpjekjeve të ndërmarra në Shqipëri për të kuptuar dhe adresuar ndikimin e komunizmit mbi viktimat dhe pasardhësit e tyre, me qëllim për t’u ardhur atyre në ndihmë. Më tej, gjetjet e studimit mund të shërbejnë si orientuese për institucionet që merren me traumën e komunizmit, përfshi këtu edhe Autoritetin e Dosjeve; për psikologët që trajtojnë njerëz nga popullata e synuar; për bashkësinë e kërkuesve shkencorë, si dhe për politikëbërësit.

Sfondi kërkimor

² Rachel Yehuda and Amy Lehrner, “Intergenerational transmission of trauma effects: putative role of epigenetic mechanisms,” *World Psychiatry* 17, no. 3 (September 7, 2018): 243–57, <https://doi.org/10.1002/wps.20568>.

³ *Friendship Act of 1993*, Pub. L. No. 103-199, 107 Stat. 2331 (1993). U.S. Congress. (1993). <https://www.congress.gov/103/statute/STATUTE-107/STATUTE-107-Pg2317.pdf>.

⁴ Natan P. F. Kellermann, “Transmission of Holocaust Trauma - An Integrative View,” *Psychiatry* 64, no. 3 (August 2001): 256–67, <https://doi.org/10.1521/psyc.64.3.256.18464>.

⁵ Natalie Flanagan et al., “Crossing borders: a systematic review identifying potential mechanisms of intergenerational trauma transmission in asylum-seeking and refugee families,” *European Journal of Psychotraumatology* 11, no. 1 (September 23, 2020), <https://doi.org/10.1080/20008198.2020.1790283>.

⁶ “Attachment” – “I lidhur ngushtësisht me dikë”, në sensin që lumturia jote, përditshmëria jote, varen nga ai person. Ai duhet t’i bëjë gjërat ashtu siç ti i dëshiron, t’i thotë gjërat ashtu siç ti i pëlqen, përndryshe ti s’je i lumtur. Ai duhet të përdorë fjalë me të cilat je dakord, që ti t’i kuptosh”. *Shënim i redaktorit*.

Në këtë kuadër, trauma ndërbreznore përfshin një proces të trefishtë: fillimisht, traumatizimin e brezit prindëror; më pas, mekanizmat përmes të cilëve kjo traumë transmetohet tek pasardhësit; dhe së fundi, ndikimin psikologjik, emocional dhe social që ajo ushtron mbi brezat vijues.⁷ Studimet mbi transmetimin ndërbreznor të traumës janë mbështetur gjerësisht në teorinë e lidhjes emocionale. Koncepti i “modeleve të brendshme të punës”, i zhvilluar nga Bowlby,⁸ së bashku me qasje të tjera të nxjerra nga kjo teori, shërbejnë si kornizë shpjeguese për mënyrën sesi marrëdhëniet e hershme prind–fëmijë ndërtojnë bazën e reagimeve të mëvonshme ndaj traumës. Krahas saj, literatura ka trajtuar edhe teorinë e sistemeve familjare, qasjet mbi stresin prindëror dhe teorinë e identitetit social, të gjitha këto të rëndësishme për të kuptuar mënyrat e shumanshme të transmetimit të traumës në kontekste familjare dhe shoqërore. Llojet e traumave të përjetuara nga brezi i prindërve përfshijnë humbjen e jetës së të afërmeve, burgosjen dhe torturimin e prindërve, si edhe humbjen e mundësive të jetesës dhe të arsimimit, të cilat kanë dëmтуar trajektoret e tyre zhvillimore dhe social-ekonomike. Hulumtimi mbi traumën ndërbreznore në vendet ish-komuniste është rritur gradualisht gjatë dy dekadave të fundit. Studime të rëndësishme janë kryer në Kamboxhia,⁹ në Vietnam¹⁰ dhe në Shqipëri.¹¹ Këto studime kanë vënë në dukje se mënyra sesi trauma ndërbreznore manifestohet, varet në masë të madhe nga konteksti specifik social-politik dhe historik i çdo vendi.

Në literaturë është theksuar, gjithashtu, roli që faktorët social-kulturorë luajnë në formësimin e simptomave të traumës ndërbreznore. Një nga këta faktorë është emigracioni, i cili mund të modifikojë efektet psikologjike të traumës, siç dëshmojnë studimet mbi emigrantët në Shtetet e Bashkuara¹². Në këtë linjë, krahasimet midis shqiptarëve që jetojnë në SHBA dhe atyre që jetojnë në Shqipëri ofrojnë një perspektivë të vlefshme për të kuptuar sesi mjedise social-kulturore të

⁷ Fred Chou et al., “Narrative themes of Chinese Canadian intergenerational trauma: Offspring perspectives of trauma transmission,” *Counselling Psychology Quarterly* 36, no. 2 (2023): 321–49, <https://doi.org/10.1080/09515070.2022.2093165>.

⁸ John Bowlby, *Attachment and Loss, Vol. 1: Attachment*, 2nd ed. (New York: Basic Books, 1969).

⁹ Field, Nigel P., Sophear Muong, dhe Vannavuth Sochanvimean, “Parental Styles in the Intergenerational Transmission of Trauma Stemming from the Khmer Rouge Regime in Cambodia,” *American Journal of Orthopsychiatry* 83, no. 4 (October 2013): 483–94, <https://doi.org/10.1111/ajop.12057>.

Nigel P. Field et al., “Parental styles in second generation effects of genocide stemming from the Khmer Rouge regime in Cambodia,” *Attachment & Human Development* 13, no. 6 (October 19, 2011): 611–28, <https://doi.org/10.1080/14616734.2011.609015>.

¹⁰ Aina B. Vaage et al., “Paternal predictors of the mental health of children of Vietnamese refugees,” *Child and Adolescent Psychiatry and Mental Health* 5 (2011), <https://doi.org/10.1186/1753-2000-5-2>.

¹¹ Blerina Kellezi, Aurora Guxholli, and Clifford Stevenson, “The dictatorship from the victims’ perspective. the role of the families,” in *The Outcast from the Power: Prisons, Internment and Forced Labour in Albania 1945-1990* (Tiranë: Konrad Adenauer Foundation, Albania, 2019), 406–18.

Blerina Kellezi et al., “‘Enemy of the people’: Family identity as social cure and curse dynamics in contexts of human rights violations,” *European Journal of Social Psychology* 51, no. 3 (February 5, 2021): 450–66, <https://doi.org/10.1002/ejsp.2750>.

Susan Greeley Murati, “A Cultural Psychological Study of the Narratives of the Ex-Politically Persecuted People of Albania: Toward a National Narrative” (Unpublished Thesis, Alliant International University, California School of Professional Psychology, UMI database number AAT 3082503, San Diego: 2003).

¹² Christopher P. Salas-Wright, Njeri Kagotho, and Michael G. Vaughn, “Mood, anxiety, and personality disorders among first and second-generation immigrants to the United States,” *Psychiatry Research* 220, no. 3 (2014): 1028–36, <https://doi.org/10.1016/j.psychres.2014.08.045>.

ndryshme ndërveprojnë me trashëgiminë e traumatizimit. Efektet psikologjike të traumës ndërbreznore të dokumentuara në literaturë përfshijnë nivele të larta ankthi dhe depresioni,¹³ vështirësi në krijimin dhe ruajtjen e lidhjeve me anëtarët e familjes,¹⁴ si edhe variacione të ndryshme që burojnë nga mjedise social-kulturore të ndryshme.¹⁵ Në këtë kontekst, marrëdhëniet midis ankthit dhe faktorëve të tillë si lidhja emocionale me prindërit, momenti i fillimit të traumës, besimi fetar dhe ndjenja e shpresës, zënë një vend të rëndësishëm. Qasjet bashkëkohore mbi shpresën e trajtojnë atë si një konstrukt shumëdimensional: një virtut teologjik,¹⁶ një virtut natyror i lidhur me qëndresën si virtut kryesor,¹⁷ si edhe si një emocion.¹⁸

Pyetjet kërkimore

- Cila është prevalenca e ankthit tek pasardhësit e rritur të viktimave të traumës së komunizmit, krahasuar me popullsinë e përgjithshme në secilin shtet?
- Cilat janë efektet e traumës ndërbreznore mbi ankthin, lidhjen (me prindërit), shpresën dhe besimin fetar?
- Cilat janë lidhjet mes ankthit, lidhjes (me prindërit), shpresës dhe besimit fetar tek pasardhësit e rritur të viktimave të traumës?
- Brenda popullsisë së synuar, a ka ndryshim midis shqiptarëve që jetojnë në SHBA dhe shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri, sa i përket prevalencës së ankthit, besimit fetar, lidhjes (së sigurt) dhe shpresës? Proceset që ndërmjetësojnë marrëdhënien mes lidhjes (me prindërit), shpresës dhe ankthit, a ndryshojnë sipas kontekstit aktual social-kulturor?

Metodat

¹³ Yael Danieli, Fran H. Norris, and Brian E. Engdahl, "A Question of Who, Not If: Psychological Disorders in Holocaust Survivors' Children," *Psychological Trauma: Theory, Research, Practice, and Policy* 9 (September 2017): 98–106, <https://doi.org/10.1037/tra0000192>.

Yael Wilchek-Aviad, Diana Cohenca-Shiby, and Yehuda Sasson, "The effects of the survival characteristics of parent Holocaust survivors on offsprings' anxiety and depression symptoms," *Israel Journal of Psychiatry and Related Sciences* 50, no. 3 (2013): 210–16, https://doctorsonly.co.il/wp-content/uploads/2014/02/10_The-Effects-of-the-Survival.pdf.

¹⁴ Marilyn Doucet dhe Martin Rovers. "Generational trauma, attachment, and spiritual/religious interventions." *Journal of Loss and Trauma*, 15, nr. 2, (2010): 93-105. <https://doi.org/10.1080/15325020903373078>.

¹⁵ Yael Danieli, Fran H. Norris dhe Brian E. Engdahl. "Multigenerational legacies of trauma: Modeling the what and how of transmission." *American Journal of Orthopsychiatry*, 86, nr.6 (2016): 639–51. <https://doi.org/10.1037/ort0000145>.

Zahava Solomon, "Transgenerational effects of the Holocaust: The Israeli research perspective," in *International Handbook of Multigenerational Legacies of Trauma. The Plenum Series on Stress and Coping.*, ed. Yael Danieli (Boston, MA: Springer, 1998), 69–83, https://doi.org/10.1007/978-1-4757-5567-1_4.

¹⁶ Craig Steven Titus et al. "Fulfilled in virtue," in *A Catholic Christian Meta-Model of the Person: Integration with psychology & mental health practice* ed. Paul C. Vitz, William J. Nordling, and Craig Steven Titus, 249-305. Sterling VA: Divine Mercy University Press, 2020.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Christopher Gross et al. "Emotional." In, *A Catholic Christian Meta-Model of the Person: Integration with psychology & mental health practice* edited by Paul C. Vitz, William J. Nordling, and Craig Steven Titus, 355-370. Sterling VA: Divine Mercy University Press, 2020.

Studimi përfshiu një kampion prej 233 të rriturish mbi 18 vjeç, të gjithë pasardhës të viktimave të komunizmit. Pjesëmarrësit jetonin në Shqipëri (n = 148) ose në Shtetet e Bashkuara (n = 84). Viktimat në historinë familjare kanë pasur persona të vrarë, të vdekur në burg, të burgosur, të lindur ose të dërguar në kampe internimi, si edhe individë që kishin përjetuar humbje të mundësive jetësore. Përzgjedhja e kampionit ishte *jo-probabilitar*¹⁹, duke përdorur “convenience”²⁰ dhe “snowball sampling”²¹. Të dhënat u mbledhën përmes një ankete Google Forms, e shpërndarë në linjë në Shqipëri dhe SHBA, dhe pjesërisht në mënyrë jashtë linje në Shqipëri.

Variablat kryesore përfshinin:

- Ankthin, i matur me *GAD-7*²²; ²³
- Llojin dhe ashpërsinë e traumës së prindërve (humbja e jetës, humbja e lirisë, humbja e mundësive);
- Lidhjen emocionale me prindërit, e matur me *ECR-RS*^{24,25}
- Përkushtimi ndaj fesë, i vlerësuar me *Centrality of Religiosity Scale*²⁶ dhe të dhëna për besimin fetar të transmetuar;
- Shpresën, e matur me *Adult Hope Trait Scale*,²⁷ duke vlerësuar dimensionet *Agency* dhe *Pathways*.

Analizat statistike përfshinë testet “Chi-square” dhe “ANOVA”,²⁸ korrelacione, regresion të shumëfishtë, dhe analiza ndërmjetësimi, në përputhje me standardet metodologjike të literaturës psikologjike.

¹⁹ “Jo përmes probabilitetit” ose “jo rastësor”,¹⁹ ku çdokush ka të njëjtën mundësi për t’u përzgjedhur. *Shënim i redaktorit.*

²⁰ “Komode” ose “e përshtatshme” - një metodë kërkimore jo rastësore, ku pjesëmarrësit përzgjidhen për shkak të lehtësisë së qasjes, gatishmërisë së tyre dhe distancës së afërt me ta. *Shënim i redaktorit.*

²¹ “Përzgjedhje me “top bore”” - një metodë kërkimore jo rastësore, ku pjesëmarrësit fillestarë tregojnë për subjekte të tjera të mundshme, duke e rritur kampionin si një “top bore që rrokulliset”; një metodë që është ideale për gjetjen e personave me vështirësi për t’u arritur, ose të fshehur. *Shënim i redaktorit.*

²² Robert L. Spitzer et al., “A Brief Measure for Assessing Generalized Anxiety Disorder: The GAD-7,” *Archives of Internal Medicine* 166 (May 22, 2006): 1092–97, <https://doi.org/10.1001/archinte.166.10.1092>.

Bernd Löwe et al., “Validation and Standardization of the Generalized Anxiety Disorder Screener (GAD-7) in the General Population,” *Medical Care* 46, no. 3 (March 2008): 266–74, <https://doi.org/10.1097/MLR.0b013e318160d093>.

²³ Shkallëzimi me 7 nivele mbi “Çrregullimin e Ankthit të Përgjithshëm”. *Shënim i redaktorit.*

²⁴ Chris R. Fraley, “Relationship Structures (ECR-RS) Questionnaire,” 2006, <https://labs.psychology.illinois.edu/~rcfraley/measures/relstructures.htm>.

Chris R. Fraley, “Information on the Experiences in Close Relationships-Revised (ECR-R) Adult Attachment Questionnaire,” University of Illinois, 2013, <https://labs.psychology.illinois.edu/~rcfraley/measures/ecrr.htm>.

²⁵ “Pyetëtori i Strukturave të Marrëdhënies” (ECR-RS) është një instrument vetëraportimi i menduar për të vlerësuar modelin e lidhjes në një sërë marrëdhëniesh të ngushta. *Shënim i redaktorit.*

²⁶ Stefan Huber and Odilo W. Huber, “The Centrality of Religiosity Scale (CRS),” *Religions*, 20 gusht 2012, <https://doi.org/10.3390/rel3030710>.

²⁷ Charles Richard Snyder et al., “The will and the ways: Development and validation of an individual-differences measure of hope,” *Journal of Personality and Social Psychology* 60, no. 4 (1991): 570–85, <https://doi.org/10.1037/0022-3514.60.4.570>.

²⁸ Testime përmes hipotezave statistikore. *Shënim i redaktorit.*

Gjetjet kryesore

Në kampionin e përgjithshëm të studimit, 27,89% e pjesëmarrësve raportuan nivele të ankthit të moderuar ose të rëndë, të vlerësuar me GAD-7 (≥ 10). Shpërndarja e prevalencës ndryshonte sipas vendit të banimit: në Shqipëri, 21,62% e pjesëmarrësve e përmbushnin këtë prag, krahasuar me 39,28% të pjesëmarrësve në SHBA. Trauma e prindërve kishte një përhapje të gjerë: pothuajse 80% e baballarëve dhe rreth 70% e nënave kishin përjetuar një formë represioni komunist. Moshë e fillimit të traumës tek babai dhe nëna rezultoi të ishte në korrelacion të fortë, duke sugjeruar ngjashmëri strukturore në historitë e traumës familjare. Analizat treguan se trauma e prindërve lidhej në mënyra të ndryshme, me të katër variablat kryesorë të studimit: ankthin, lidhjen emocionale, përkushtimin ndaj fesë dhe shpresën. Trauma e babait ishte e lidhur me praninë e ankthit në kampionin e përgjithshëm dhe ndikonte lidhjen e ankthshme me babanë, tek pjesëmarrësit në Shqipëri. Ashpërsia e traumës së babait lidhej gjithashtu me nivelin e arsimimit të pasardhësve në SHBA. Trauma e nënës paraqiti ndërveprime të shumanshme. Ajo ishte e lidhur me llojin e besimit fetar të transmetuar te fëmijët; me nënat katolike që raportonin nivele më të larta traume krahasuar me kategoritë e tjera fetare. Në Shqipëri, pjesëmarrësit me nëna që kishin përjetuar trauma shfaqnin ankth më të lartë dhe lidhje më pak shmangëse me babanë. Trauma kryesore e nënës ndikoi shpresën (Pathways) tek pjesëmarrësit në Shqipëri dhe përkushtimin ndaj fesë (CRS) tek pjesëmarrësit në SHBA. Ashpërsia e traumës së nënës rezultoi gjithashtu e lidhur me shpresën (Pathways) në Shqipëri. Pavarësisht historive të rënda të traumës familjare, pasardhësit e viktimave të komunizmit në Shqipëri, nga të dy vendet (Shqipëri dhe SHBA), u karakterizuan nga nivele të konsiderueshme të përkushtimit ndaj fesë dhe shpresës. Analizat e mëtejshme treguan se ndikimi i traumës së nënës, në shpresë (Pathways dhe AHTS) nuk buronte nga besimi fetar në rastin e nënave myslimane, ndërsa testet e transformimit R-në-Z, për koeficientët e korrelacionit midis përkushtimit ndaj fesë (CRS) dhe shpresës, treguan një tendencë më të fortë të besimit katolik për t'u shoqëruar me nivele më të larta shprese, krahasuar me besimet ortodokse, myslimane dhe besimin e kategorisë “një Zot”. Në të dy vendet, ankthi ishte pozitivisht i lidhur me lidhjen e ankthshme. Modeli i regresionit të shumëfishtë shpjegoi 7,2%-shin të ndryshimit të ankthit në Shqipëri dhe 26,8% në SHBA. Lidhja e ankthshme, megjithëse korreloi me ankthin, nuk e parashikoi në mënyrë statistikisht domethënëse ankthin, në asnjërin prej modeleve. Në kampionin e SHBA-ve, shpresa e parashikoi negativisht ankthin, ndërsa përkushtimi ndaj fesë e parashikoi pozitivisht ankthin, duke sugjeruar role të ndryshme të këtyre ndryshoreve në kontekstet social-kulturore përkatëse.

Diskutimi

Gjetjet e studimit treguan se prevalenca e ankthit, si në kampionin e Shqipërisë, ashtu edhe në atë të SHBA-ve, ishte dukshëm më e lartë sesa nivelet e raportuara në studime të mëparshme

ndërkombëtare, të kryera nga OBSH,²⁹ si edhe në studime të mëvonshme, të kryera në Shqipëri³⁰ dhe SHBA.³¹ Nivelet e ankthit të identifikuara në këtë studim tejkaluan edhe shkallët e ankthit të raportuara në studimet e kryera gjatë pandemisë COVID-19,³² duke sugjeruar se pasojat ndërbreznore të traumës së komunizmit mund të kontribuojnë në rritjen e simptomave të ankthit në këtë popullatë. Korrelacioni i fortë midis moshës së fillimit të traumës tek babai dhe nëna sugjeron një model të qëndrueshëm në mënyrën sesi regjimi komunist vepronte ndaj individëve dhe familjeve. Ky model ndëshkues duket të ketë pasur një strukturë të dyfishtë: sulmi nuk ishte i orientuar vetëm ndaj individit të shpallur “armik”, por shpesh përfshinte edhe bashkëshortin/en, duke dëmtuar minimalisht dy anëtarë të familjes. Ky konfigurim ka të ngjarë të ketë forcuar ndikimet ndërbreznore të traumës. Rezultatet treguan se trauma e prindërve lidhej në mënyrë të qëndrueshme me të katër ndryshoret kryesore të studimit (ankthin, lidhjen, përkushtimin ndaj fesë dhe shpresën) dhe se këto efekte ishin veçanërisht të dukshme në kampionin e Shqipërisë. Prania e këtyre efekteve në brezin e dytë tregon se pasojat e traumës së përjetuar në Shqipërinë komuniste janë ende të pranishme në gjendjen psikologjike të pasardhësve. Në Shqipëri, pjesëmarrësit me nëna që kishin përjetuar trauma shfaqnin ankth më të lartë dhe lidhje më pak shmangëse ndaj babait, duke sugjeruar një proces kompensimi në strukturën e lidhjes prindërore. Këto gjetje ofrojnë edhe indikatorë të qartë për ndërhyrje psikologjike dhe psiko-edukative. Duke qenë se trauma e nënës paraqiti një ndikim të veçantë në disa ndryshore kryesore, ndërhyrjet fillestare duhet të orientohen drejt pasardhësve të atyre nënave që përjetuan traumat më të rënda. Për shkak të diferencave të dukshme midis mjediseve social-kulturore dhe grupeve fetare, në kampion, ndërhyrjet e mundshme duhet të jenë të përshtatura sipas kontekstit të individit.

Këtu përfshihet:

- (i) adresimi i shpresës teologjike për individët katolikë, bazuar në Shkrimin e Shenjtë, Katekizmin e Kishës Katolike dhe Meta-Modelin e Njeriut të Krishterëwho Katolik (CCMMP), me përshtatje për grupet jo-katolike;
- (ii) ndërhyrje të orientuara drejt qetësimit të lidhjes e ankthshme dhe shmangëse, duke kombinuar CCMMP, mësimet e Katekizmit dhe Teorinë e Lidhjes;
- (iii) ndërhyrje për të mbështetur rritjen në virtytin e shpresës, përmes rritjes së guximit³³ dhe përmes forcimit të vullnetit dhe maturisë morale;

²⁹ World Health Organization “*Depression and other common mental disorders: global health estimates*. Geneva: World Health Organization, 2017. <https://iris.who.int/server/api/core/bitstreams/6bab42bc-df0f-4f68-a86d-28ebdb85e42/content>.

³⁰ Fatjona Kamberi et al., “Impact of COVID-19 pandemic on mental health, risk perception and coping strategies among health care workers in Albania - evidence that needs attention,” *Clinical Epidemiology and Global Health* 12 (June 29, 2021), <https://doi.org/10.1016/j.cegh.2021.100824>.

³¹ Emily P. Terlizzi and Maria A. Villarroe, “Symptoms of Generalized Anxiety Disorder Among Adults: United States, 2019,” *NCHS Data Brief* 378 (September 2020), <https://www.cdc.gov/nchs/data/databriefs/db378-H.pdf>.

³² Fatime Elezi et al., “Assessment of anxiety and depression symptoms in the Albanian general population during the outbreak of COVID-19 pandemic,” *Indian Journal of Psychiatry* 62, no. Suppl 3 (September 28, 2020): 470–75, <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC7659795/>.

³³ Titus et al. “Fulfilled in virtue”.

- (iv) ndërhyrje që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës së prekur në Shqipëri, në përputhje me perspektivën e Lazarus për shpresën si emocion.³⁴

Korrelacionet midis ankthit dhe lidhjes së ankthshme, si edhe gjetjet nga modeli i regresionit të shumëfishtë në kampionin e SHBA-ve, ishin në përputhje me literaturën ekzistuese. Ndërkohë, modeli i regresionit në kampionin e Shqipërisë shpjegoi një pjesë relativisht të vogël të ndryshimit të ankthit (7,2%), gjë që mund të lidhet me praninë e disa faktorëve të tjerë ndërbreznorë (p.sh., zemërimi, depresioni, dëshpërimi), të cilët mund të ndërveprojnë me traumën prindërore dhe të përkeqësohen nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj krizave social-ekonomike aktuale dhe të ndikojnë nga ana e tyre mbi ankthin.³⁵ Në tërësi, gjetjet e këtij studimi kanë implikime të rëndësishme si në mjedise klinike ashtu edhe në ato joklinike, duke përfshirë edukimin e pacientëve potencialë, familjarëve dhe rrjeteve mbështetëse, profesionistëve të shëndetit mendor, si edhe politikëbërësve dhe vendimmarrësve që synojnë të hartojnë politika të orientuara drejt popullatave të prekura nga trauma ndërbreznore.

Përfundime

- Gjetjet e studimit treguan se prevalenca e ankthit të moderuar dhe të rëndë në të dy kampionet (Shqipëri dhe SHBA) është mjaft e lartë dhe përputhet me nivelin e një gjendjeje të mundshme klinikisht të rëndësishme. Kjo tregon se ekziston një nevojë urgjente për ndërhyrje që mbështesin popullatën e synuar, në përballjen me simptomat e ankthit dhe reduktimin e rrezikut për zhvillimin e çrregullimeve të ankthit.
- Rezultatet lidhën në mënyrë të qëndrueshme traumën e prindërve me katër ndryshoret kryesore të studimit (ankthin, lidhjen, përkushtimin ndaj fesë dhe shpresën). Efektet psikologjike të traumave prindërore ishin më të theksuara në kampionin e Shqipërisë, duke treguar se ndikimi ndërbreznor i traumës së komunizmit mbetet i pranishëm edhe sot në brezin e pasardhësve. Kjo mund të jetë drejtpërdrejt e lidhur me faktin se realiteti i sotëm në Shqipëri shkakton një ekspozim të vazhdueshëm ndaj traumës.
- Një tjetër gjetje e rëndësishme ishte roli i “humbjes së mundësisë”, e cila doli të ishte faktori që çoi në mesatarët më të larta në disa analiza ANOVA. Ky rezultat sugjeron se “humbja e mundësisë” mund të përbëjë një formë të veçantë dhe të veçuar traume, me pasoja ndërbreznore potencialisht më të thella. Për këtë arsye, një pyetësor më i detajuar, që dallon nënshtresat e humbjes së mundësive, mund të përbëjë bazë për kërkime të mëtejshme.
- Studimi identifikoi ndryshime në mënyrën sesi trauma ndikon në shpresë tek pasardhësit e atyre prindërve që u kanë transmetuar besime fetare të ndryshme. Rastet e pjesëmarrësve

³⁴ Richard S. Lazarus, “Hope: An Emotion and a Vital Coping Resource Against Despair,” *Social Research: An International Quarterly* 66, no. 2 (season-02 1999): 653–78, <https://www.jstor.org/stable/40971343>.

³⁵ Laurence J. Kirmayer et al., “Trauma and disasters in social and cultural context,” in *Principles of Social Psychiatry*, ed. Dinesh Bhugra and Craig Morgan, vol. 2 (New York: Wiley-Blackwell, 2010), 155–77.

me “origjinë” katolike mund të sugjerojnë një shembull të shpresës teologjike, por kjo hipotezë kërkon hulumtime të mëtejshme për t’u mbështetur.

- Ndryshimet e mjediseve social-kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA-ve prodhuan rezultate të ndjeshme në analizat e këtij studimi, duke sugjeruar se ndërhyrjet e mundshme psikologjike dhe sociale duhet të jenë të përshtatura sipas vendndodhjes gjeografike dhe kontekstit kulturor.
- Në kampionin e SHBA-ve rezultatet treguan se përkushtimi ndaj fesë ishte një parashikues pozitiv i ankthit, ndërsa shpresa ishte një parashikues negativ. Në bazë të këtyre gjetjeve, ndërhyrjet që adresojnë mënyrën sesi edukohet, përcillet e përjetohet përkushtimi ndaj fesë dhe/ose që synojnë rritjen e shpresës mund të reduktojnë prevalencën dhe intensitetin e ankthit në këtë popullatë.
- Duke u mbështetur në gjetjet mbi shpresën, lidhjen dhe përkushtimin ndaj fesë, ndërhyrjet e mundshme për të mbështetur popullatën e synuar mund të përfshijnë: qasje që adresojnë shpresën teologjike, ndërhyrje që synojnë të qetësojnë lidhjen ankthshme dhe shmangëse, si dhe programe që synojnë rritjen e shpresës, si virtyt dhe emocion. Këto ndërhyrje mund të bazohen në mësimet e CCMMP (Meta-Modelit të Krishterë Katolik të Njeriut) dhe të përshtaten më tej për pjesëmarrësit e besimeve të tjera fetare (të krishterë ortodoksë dhe myslimanë, apo për pjesëmarrës që besojnë në “një Zot”, ose pjesëmarrës jofetarë).

Në tërësi, gjetjet e këtij studimi kanë implikime të rëndësishme për mjedise klinike dhe joklinike, duke përfshirë dizajnimin e qasjeve terapeutike, psikoedukimin, mbështetjen familjare dhe hartimin e politikave që adresojnë pasojat ndërbreznore të traumës së komunizmit.

Bibliografia

- Literatura

1. Bowlby, John. *Attachment and Loss, Vol. 1: Attachment*. 2nd ed. New York: Basic Books, 1969.
2. Gross, Christopher, Craig Steven Titus, William J. Paul C. Vitz dhe Nordling. “Emotional.” In, *A Catholic Christian Meta-Model of the Person: Integration with psychology & mental health practice* edited by Paul C. Vitz, William J. Nordling, and Craig Steven Titus, 355-370. Sterling VA: Divine Mercy University Press, 2020.
3. Huber, Stefan. *Centrality and content: A new multidimensional measurement model of religiosity*. Opladen: Leske and Budrich, 2003.
4. Kellezi, Blerina, Aurora Guxholli, dhe Clifford Stevenson. “The dictatorship from the victims’ perspective. the role of the families.” In *The Outcast from the Power: Prisons, Internment and Forced Labour in Albania 1945-1990*, 406–18. Tiranë: Konrad Adenauer Foundation, Albania, 2019.
5. Kirmayer, Laurence J., Hanna Kienzler, Duncan Pedersen, and Abdelhamid J. D. R. Afana. “Trauma and disasters in social and cultural context.” In *Principles of Social Psychiatry*,

edited by Dinesh Bhugra and Craig Morgan, 2:155–77. New York: Wiley-Blackwell, 2010.

6. Titus, Craig Steven, William J. Nordling dhe Paul C. Vitz. “Fulfilled in virtue.” In, *A Catholic Christian Meta-Model of the Person: Integration with psychology & mental health practice* edited by Paul C. Vitz, William J. Nordling, and Craig Steven Titus, 249-305. Sterling VA: Divine Mercy University Press, 2020.
6. Titus, Craig Steven, Paul C. Vitz dhe William J. Nordling. “Interpersonally Relational.” In, *A Catholic Christian Meta-Model of the Person: Integration with psychology & mental health practice* edited by Paul C. Vitz, William J. Nordling, and Craig Steven Titus, 306-330. Sterling VA: Divine Mercy University Press, 2020.

- Revista

1. Chou, Fred, Marla J. Buchanan, Marvin McDonald, Marvin Westwood, and Carmen Huang. “Narrative themes of Chinese Canadian intergenerational trauma: Offspring perspectives of trauma transmission.” *Counselling Psychology Quarterly* 36, no. 2 (2023): 321–49. <https://doi.org/10.1080/09515070.2022.2093165>
2. Danieli, Yael, Fran H. Norris dhe Brian E. Engdahl. “Multigenerational legacies of trauma: Modeling the what and how of transmission.” *American Journal of Orthopsychiatry* 86, nr.6, (2016): 639–51. <https://doi.org/10.1037/ort0000145>.
3. Danieli, Yael, Fran H. Norris, dhe Brian E. Engdahl. “A Question of Who, Not If: Psychological Disorders in Holocaust Survivors’ Children.” *Psychological Trauma: Theory, Research, Practice, and Policy* 9, (September 2017): 98–106. <https://doi.org/10.1037/tra0000192>.
4. Dekel, Rachel, and Hadass Goldblatt. “Is there intergenerational transmission of trauma? The case of combat veterans’ children.” *American Journal of Orthopsychiatry* 78, no. 3 (2008): 281–89. <https://doi.org/10.1037/a0013955>.
5. *Depression and other common mental disorders: global health estimates*. World Health Organization, Geneva: World Health Organization, 2017. <https://iris.who.int/server/api/core/bitstreams/6bab42bc-df0f-4f68-a86d-28ebedb85e42/content>.
6. Doucet, Marilyn dhe Martin Rovers. “Generational trauma, attachment, and spiritual/religious interventions.” *Journal of Loss and Trauma*, 15, nr. 2, (2010): 93-105. <https://doi.org/10.1080/15325020903373078>.
7. Elezi, Fatime, Griselda Tafani, Eugjen Sotiri, Herta Agaj, dhe Kristi Kola. “Assessment of anxiety and depression symptoms in the Albanian general population during the outbreak of COVID-19 pandemic.” *Indian Journal of Psychiatry* 62, no. Suppl 3 (September 28, 2020): 470–75. <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC7659795/>.
8. Field, Nigel P., Sophear Muong, dhe Vannavuth Sochanvimean. “Parental Styles in the Intergenerational Transmission of Trauma Stemming from the Khmer Rouge Regime in Cambodia.” *American Journal of Orthopsychiatry* 83, no. 4 (October 2013): 483–94. <https://doi.org/10.1111/ajop.12057>.
9. Field, Nigel P., Chariya Om, Thida Kim, dhe Sin Vorn. “Parental styles in second generation effects of genocide stemming from the Khmer Rouge regime in Cambodia.” *Attachment*

- & *Human Development* 13, no. 6 (October 19, 2011): 611–28. <https://doi.org/10.1080/14616734.2011.609015>.
10. Flanagan, Natalie, Aine Travers, Frederique Vallières, Maj Hansen, Rory Halpin, Greg Sheaf, Nina Rottmann, and Anna Thit Johnsen. “Crossing borders: a systematic review identifying potential mechanisms of intergenerational trauma transmission in asylum-seeking and refugee families.” *European Journal of Psychotraumatology* 11, no. 1 (September 23, 2020). <https://doi.org/10.1080/20008198.2020.1790283>.
 11. Forrest, Walter, Ben Edwards, and Galina Daraganova. “The intergenerational consequences of war: anxiety, depression, suicidality, and mental health among the children of war veterans.” *International Journal of Epidemiology* 47, no. 4 (August 2018): 1060–67. <https://doi.org/10.1093/ije/dyy040>.
 12. Fraley, Chris R. “Relationship Structures (ECR-RS) Questionnaire.” University of Illinois, 2006. <https://labs.psychology.illinois.edu/~rcfraley/measures/relstructures.htm>.
 13. Fraley, Chris R. “Information on the Experiences in Close Relationships-Revised (ECR-R) Adult Attachment Questionnaire.” University of Illinois, 2013. <https://labs.psychology.illinois.edu/~rcfraley/measures/ecrr.htm>.
 14. Greeley Murati, Susan. “A Cultural Psychological Study of the Narratives of the Ex-Politically Persecuted People of Albania: Toward a National Narrative.” Unpublished Thesis, Alliant International University, California School of Professional Psychology, UMI database number AAT 3082503, San Diego: 2003.
 15. Huber, Stefan, and Odilo W. Huber. “The Centrality of Religiosity Scale (CRS).” *Religions*, 20 Gusht 2012. <https://doi.org/10.3390/rel3030710>.
 16. Kamberi, Fatjona, Enkeleda Sinaj, Jerina Jaho, Subashi Brunilda, Glodiana Sinanaj, Kristela Jaupaj, Yllka Stramarko, et al. “Impact of COVID-19 pandemic on mental health, risk perception and coping strategies among health care workers in Albania - evidence that needs attention.” *Clinical Epidemiology and Global Health* 12 (June 29, 2021). <https://doi.org/10.1016/j.cegh.2021.100824>.
 17. Kellermann, Natan P. F. “Transmission of Holocaust Trauma - An Integrative View.” *Psychiatry* 64, no. 3 (August 2001): 256–67. <https://doi.org/10.1521/psyc.64.3.256.18464>.
 18. Kellezi, Blerina, Aurora Guxholli, Clifford Stevenson, Juliet Ruth Helen Wakefield, Mhairi Bowe, dhe Kay Bridger. “‘Enemy of the people’: Family identity as social cure and curse dynamics in contexts of human rights violations.” *European Journal of Social Psychology* 51, no. 3 (February 5, 2021): 450–66. <https://doi.org/10.1002/ejsp.2750>.
 19. Lazarus, Richard S. “Hope: An Emotion and a Vital Coping Resource Against Despair.” *Social Research: An International Quarterly* 66, no. 2 (season-02 1999): 653–78. <https://www.jstor.org/stable/40971343>.
 20. Löwe, Bernd, Oliver Decker, Stefanie Müller, Elmar Brähler, Dieter Schellberg, Wolfgang Herzog, and Philipp Yorck Herzberg. “Validation and Standardization of the Generalized Anxiety Disorder Screener (GAD-7) in the General Population.” *Medical Care* 46, no. 3 (March 2008): 266–74. <https://doi.org/10.1097/MLR.0b013e318160d093>.
 21. Rosenheck, Robert, and Alan Fontana. “Transgenerational effects of abusive violence on the children of Vietnam combat veterans.” *Journal of Traumatic Stress* 11, no. 4 (1998): 731–42. <https://doi.org/10.1023/A:1024445416821>.
 22. Salas-Wright, Christopher P., Njeri Kagotho, dhe Michael G. Vaughn. “Mood, anxiety, and personality disorders among first and second-generation immigrants to the United States.”

- Psychiatry Research* 220, no. 3 (2014): 1028–36.
<https://doi.org/10.1016/j.psychres.2014.08.045>.
23. Snyder, C. R., Harris, C., Anderson, J. R., Holleran, S. A., Irving, L. M., Sigmon, S. T., Yoshinobu, L., Gibb, J., Langelle, C., & Harney, P. (1991). The will and the ways: Development and validation of an individual-differences measure of hope. *Journal of Personality and Social Psychology*, 60(4), 570–585. <https://doi.org/10.1037%2F0022-3514.60.4.570>
 24. Solomon, Zahava. “Transgenerational effects of the Holocaust: The Israeli research perspective.” In *International Handbook of Multigenerational Legacies of Trauma. The Plenum Series on Stress and Coping.*, edited by Yael Danieli, 69–83. Boston, MA: Springer, 1998. https://doi.org/10.1007/978-1-4757-5567-1_4.
 25. Spitzer, Robert L., Kurt Kroenke, Janet B. W. Williams, and Bernd Löwe. “A Brief Measure for Assessing Generalized Anxiety Disorder: The GAD-7.” *Archives of Internal Medicine* 166 (May 22, 2006): 1092–97. <https://doi.org/10.1001/archinte.166.10.1092>.
 26. Terlizzi, Emily P., and Maria A. Villarroel. “Symptoms of Generalized Anxiety Disorder Among Adults: United States, 2019.” *NCHS Data Brief* 378 (September 2020). <https://www.cdc.gov/nchs/data/databriefs/db378-H.pdf>.
 27. Vaage, Aina B., Per Hove Thomsen, Cécile Rousseau, Tore Wentzel-Larsen, and Edvard Hauff. “Paternal predictors of the mental health of children of Vietnamese refugees.” *Child and Adolescent Psychiatry and Mental Health* 5 (2011). <https://doi.org/10.1186/1753-2000-5-2>.
 28. Wilchek-Aviad, Yael, Diana Cohenca-Shiby dhe Yehuda Sasson. “The effects of the survival characteristics of parent Holocaust survivors on offsprings’ anxiety and depression symptoms.” *Israel Journal of Psychiatry and Related Sciences* 50, no. 3 (2013): 210–16. https://doctorsonly.co.il/wp-content/uploads/2014/02/10_The-Effects-of-the-Survival.pdf.
 29. Yehuda, Rachel, and Amy Lehrner. “Intergenerational transmission of trauma effects: putative role of epigenetic mechanisms.” *World Psychiatry* 17, no. 3 (September 7, 2018): 243–57. <https://doi.org/10.1002/wps.20568>.

- Webfage

1. U.S. Congress. (1993). *Friendship Act of 1993, Pub. L. No. 103-199, 107 Stat. 2331* (1993). <https://www.congress.gov/103/statute/STATUTE-107/STATUTE-107-Pg2317.pdf>.